



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of the Permanent Secretary

Kancelarija Stalnog Sekretara

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

**LËNDA :REGJISTRIMI I NXËNËNËSVE NË KLASËN E PARË**  
**NUMËR:MASHT:16/2004**  
**DATË: 07. 05 04**

Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.1 dhe 7.4 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, dhe nenit 5 paragrafi 5.4 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

### Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktoj regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë ( moshën, dokumentacionin e nevojshëm , afatin e regjistrimit dhe mënyrën e regjistrimit).

### Neni 2 Moshë

2.1. Fëmija mund të regjistrohet në klasën e parë pasi t'i ketë mbushur moshën minimale ( gjashtë vjet ), por mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arsimit të detyruar, në fillim të vitit shkollor me vlerësim të mjekut dhe të psikologut.Vendimin e merr Drejtoria Komunale e Arsimit.

**Neni 3**  
**Dokumentacioni**

**3.1. Për regjistrim në klasë të parë, fëmiju duhet të ketë certifikatën e lindjes.**

**Neni 4**  
**Afati i regjistrimit**

**4.1. Regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë, fillon më 17 maj dhe zgjat deri me 7 qershor.**

**4.2. Nga data 14 -18 qershor, fëmijët e regjistruar në shkollat përkatëse shoqërorizohen me mësuesin/en në orët mësimore.**

**4.3. Me rastin e përfundimit të mësimimit (18 qershor), organizohet një ceremoni modeste festive nga secili mësues/e, në klasën gjegjëse në prani të prindërve.**

**Neni 5**  
**Mënyra e regjistrimit**

**5.1. Fëmijët i nënshtrohen një vlerësimi profesional, lidhur me përcaktimin e shkallës së aftësive të tij dhe kategorizimi.**

**5.2. Vlerësimi bëhet nga organi profesional i shkollës :**

- a) Mësuesi /ja,**
- b) Pedagogu,**
- c) Psikologu,**

**5.3. Vlerësimi dhe regjistrimi i nxënësit bëhet në prani të (së paku) njërit nga prindërit (kujdestarit).**

**5.4. Regjistrimi i fëmijut (pasi t'i ketë përmbushur kriteret) bëhet në Librin për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë.**

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

**6.1. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi , me nënshkrimin e Sekretarit të Përhershëm .**

---

**Isuf Zeneli ,Sekretari i Përhershëm**